

UDHËZIM
Nr. 6/8, datë 5.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 38 “Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore”, pika I “Në furnizimet e përjashtuara nga TVSH për transaksionet me interes të përgjithshëm bazuar në nenin 51 pikat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “ll” të ligjit përfshihen”, nënpika 1, shtohet kodi si më poshtë:

Përshkrimi	Kodet e NKM
Proteza artikulationesh të implantueshme	9021 31 00 100

2. Në nenin 38 “Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore”, pika I “Në furnizimet e përjashtuara nga TVSH për transaksionet me interes të përgjithshëm bazuar në nenin 51 pikat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “ll” të ligjit përfshihen”, nënpika 1, kodi tarifor “90213990100”, i artikullit “stenta vaskulare”, ndryshohet si më poshtë:

Përshkrimi	Kodet e NKM
Stenta vaskulare të implantueshme	90219090100

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani